**LIGJ**
**Nr.10 282, datë 24.5.2010**

# PËR DHËNIEN E LEJES SË HYRJES DHE TË QËNDRIMIT TË PËRKOHSHËM NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË NJË FORCE USHTARAKE TURKE

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Lejohet hyrja dhe qëndrimi i përkohshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë i një force ushtarake turke, e përbërë nga 1125 (një mijë e njëqind e njëzet e pesë) trupa të imbarkuar në 5 (pesë) anije.

Neni 2

Leja e hyrjes dhe e qëndrimit të përkohshëm të kësaj force ushtarake turke jepet për periudhën 22 qershor 2010 deri më 25 qershor 2010.

Neni 3

Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6594, datë 31.5.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi**